



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

**Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor**  
**Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja**  
**Ministry of Environment and Spatial Planning**

Zyra e Sekretarit të Përhershëm/Kancelarija Stalnoq Sekretara/Office of the Permanent Secretary

DATË/A:	22.03.2013
REFERENC-Ë:	3568/12 - ZSP - /2013
PËR/ZA/TO:	N.N.T. „BRODEA” fsh. Brod, K. Shtërpc
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Arben ÇITAKU, Sekretar i Përgjithshëm në MMPH
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	VENDIM



Sipas kërkesës suaj me nr. të protokollit: 3568/12, organi kompetent i MMPH-së ka shqyrtuar aplikacionin për Leje Ujore, dhe ka vendosur si në Vendimin e bashkangjitur të kësaj letër përcjellëse.

Faqe 1 nga 4



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

**Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor**  
**Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja**  
**Ministry of Environment and Spatial Planning**

Zyra e Sekretarit të Përhershëm/Kancelarija Stalnoq Sekretara/Office of the Permanent Secretary

Në bazë të nenit 56 të Ligjit mbi Ujërat e Kosovës (Rr Nr. 2004/24) dhe nenit 90 të Ligjit për Procedurë Administrative (Nr. 02/L-28), Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë, lëshon këtë:

**LEJE UJORE**

**APROVOHET** kërkesa e kompanisë N.N.T.“BRODEA” , fshati Brod, K Shtërpc, lidhur me shfrytëzimin e ujit nga burimi në ngastrën me nr 978/1 dhe 978 /2, në ngastrën kadastrale UL -72710009-00017, zona kadastrale Brod, K. Shtërpc, me koordinata Y= 7508982,69; X= 4679577,22 , të burimit të ujit per fabrikën e ambalazhimit të ujit.

**Leja Ujore jepet me këto kushte :**

- Sasia maksimale e shfrytëzimit të ujit nga burimi do të jetë, 2.0 lit/sek (dy litra per sekond, sipas projektit “Elaborati i shfrytëzimit të ujit” ).
- Për plotësimin e kushtit si më sipër, pala duhet të hartoj elaboratin e shfrytëzimit të ujit, si dhe të prezantoj të dhënat hidrologjike për burimin;
- Duhet të sjellë situacionin me perpjesë të lexueshme, në afat ligjor jo me te vjetër se gjashtë muaj, te punuar nga palë e licencuar në Agjencionin Kadastral të Kosovës.
- Pala përmes regjistrimit me anën e ujëmatësve të vendosur në kaptazhen e burimit si dhe në hyrje të fabrikës duhet të evidentoj : Prurjen mesatare ditore (l/s), sasinë ditore (m<sup>3</sup> /ditë), sasinë vjetore (m<sup>3</sup>/muaj) dhe sasinë vjetore (m<sup>3</sup>/vit). Për sasinë të shfrytëzuara pala obligohet që për çdo tre muaj të informoj me shkrim MMPH-në;

Faqe 2 nga 4



- Në raste se paraqitet nevoja për shfrytëzim publik të ujit, pala obligohet me aktvendim të posaçëm sipas nevojës ta redukton sasinë e shfrytëzimit të ujit, apo edhe ta ndërpres;
- Të ruaj ekuilibrin ekologjik të ujërrjedhës;
- Obligimi për pagimin e kompensimeve për shfrytëzimin e ujërave për ambalazhim, do të përcaktohet me aktvendim të posaçëm nga MMPH-ja, sipas U.A. Nr. 06/2006, për Strukturën e Pagesave të Ujit;
- Për këtë pala obligohet të raportoj mbi sasinë e shitur të ujit, ashtu që të plotësohet kushti paraprak;
- Afati i lëshimit të lejes Ujore është 2 vjet, me mundësi zgjatjeje sipas kërkesës së palës;
- Për vazhdimin e kohëzgjatjes së Lejes Ujore, bartësi është i obliguar që së paku 6 (gjashtë) muaj para skadimit të afatit të paraqes kërkesë për vazhdimin të përdorimit;
- Në rast se pala vendos, lidhur me rritjen apo zvoglimin e shfrytëzimit, duhet të bëjë kërkesë për ndryshim të lejes ujore;

#### Arsyetim

Sipas kërkesës me Nr. të protokollit: 3568/12, N.N.T. "BRODEA", Fsh. Brod, K. Shtërpce ka aplikuar për Leje Ujore lidhur me shfrytëzimin e ujit nga burimi në zonën kadastrale nr. 978/1 dhe 978/2 UL.- 72710009-00017, vendi Agushaj – Reç, zona kadastrale Brod, K. Shtërpce, regjistruar si, pronë private e palës. Pala kërkesës ia ka bashkangjitur dokumentacionin investivo- teknik si ne vijim:

1. Formularin e aplikimit për Leje Ujore;
2. CD-në;
3. Faturën e pagesës për aplikim;
4. Elaboratin mbi shfrytëzimin e ujit nga burimi në fsh. Brod, K. Shtërpce, për nevojat e fabrikës për ambalazhimin e ujit;
5. Autorizimin për kompaninë hartuese;
6. Certifikata e regjistrimit të N.N.T "BRODEA";
7. Kopje plani për ngastrat 668, 669/2;
8. Certifikata mbi të drejtën e pronës së paluajtshme;
9. Kopje plani për ngastrat 978/1; 978/2;
10. Certifikatën mbi të drejtën e pronës së paluajtshme; për ngastrat si me sipër;
11. Lejen për mihjen në pronën shtetërore pranë rrugës në vendin e quajtur "Ropot" lëshuar nga K. Shtërpce.
12. Vendimi për pelqim mjedisore;
13. Plani i situacionit;
14. Certifikata e kompanisë hartuese;
15. Diploma e doktoratës së hartuesit;
16. Analizat fiziko- kimike dhe mikrobiologjike lëshuar nga IKSHPK;



Në kuadër të procedurave për shqyrtim të kërkesave është bërë shikimi në vend, datë 11.03.2013 është vizituar burimi, dhe vendi se ku parashihet të ndërtohet fabrika. Është vërejtur se kaptazha është e ndërtuar, gjatë shikimit në vend është mbajtur procesverbali me nr. rendor 09/201 dhe është nënshkruar nga përfaqësuesi i DU-së dhe palës.

Në bazë të dokumentacionit – investivo teknik të dorëzuar, shikimit në vend dhe në harmoni me politikat zhvillimore ekonomike të Kosovës është vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

**KËSHILLA JURIDIKE :**

Pala e pakënaqur, ka të drejtë në iniciimin e procedurës së Kontestit administrativ, në Gjykatën Supreme të Kosovës, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor  
Nr. 3568/12- ZSP -242/13 datë 22.03.2013  
Prishtinë

1. Palës
2. Kabinetit të Ministrit
3. Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm
4. K. Shtërpce
5. AKMM-së
6. Inspektoratit
7. DU-së
8. Arkivit të MMPH-së

Sekretar i Përgjithshëm

